

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë Drejtoria e Menaxhimit të Biznesit dhe Riskut Operacional / Sektori i Menaxhimit të Riskut Operacional.

SPECIALIST

Specialisti angazhohet për realizimin e objektivave të sektorit dhe detyrave të caktuara, me qëllim mirëfunksionimin e veprimtarisë së sektorit për Administrimin e Riskut Operacional.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të njihet me Procedurat Operacionale, Udhëzimet e Punës, Rregulloren si dhe referencat ligjore të strukturës me të cilat do të fillojë punën për Analizën e Riskut Operacional sipas planit të punës dhe objektivave të sektorit të miratuar dhe dërguar nga eprori drejtpërdrejtë.
- Asiston dhe monitoron Zotëruesin e Riskut të njësisë në plotësimin e Hartës së Proçeseve të strukturës që do të fillojë analiza e riskut në lidhje me unifikimin e proçeseve, nënproçeseve dhe aktiviteteve të punës sipas dokumentacionit operacional që ka struktura si dhe raporton periodikisht tek eprori i drejtëpërdrejtë.
- Referuar Hartës së Proçeseve, identifikon risqet dhe i kategorizon në regjistrin e Riskut, sipas kategorizimeve të Udhëzimeve të Punës.
- Në bashkëpunim me Zotëruesin e Riskut kryen vlerësimin e risqeve bazuar në indikatorët (propabilitet dhe ndikim), sugjeron masat parandaluese në Regjistrin e Riskut dhe së bashku me Zotëruesin e Riskut plotësojnë qasjen ndaj riskut me qëllim parandalimin dhe minimizimin e risqeve.
- Përgatit informacion për eprorin e drejtëpërdrejtë ku duhet të përmirësohen proçedurat sipas analizës së riskut të kryer, në bashkëpunim me sektorin e proçedurave.
- Përgatit informacionin e nevojshëm për përditësimin e Regjistrit të përgjithshëm të riskut të shoqërisë.
- Mirëmban dhe përditëson databazën elektronike të të gjitha analizave të riskut të miratuara.
- Përgatit cdo korespondencë shkresore, aktivitete të tjera të ngarkuara nga eprori për çështje që lidhen me sektorin.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplome Universitare në fushën e shkencave ekonomike / juridike ose në një fushë të ngjashme.
- Eksperiencë pune të ngjashme mbi 2 vjet.
- Njohuri të mira në përdorimin e programeve bazë kompjuterike (Exel, Word, Power point)
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi për të bashkëvepruar me kolegët dhe drejtuesit.

Dokumentat për dorëzim:

- Curriculum Vitae (CV).
- Letër Interesi – në të cilën duhet të specifikohen arsyet të cilat ju mendojnë se ju bëjnë një kandidat potencial për këtë pozicion.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.